REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12 dhe 17 shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 154 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative , nenit 9 shkronja a) dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.06.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M
MBI PEZULLIMIN E PËRKOHSHËM TË ZBATIMIT TË RREGULLORES PËR ORARIN E PUNËS TË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE NR.15-330/02-22376 TË DATËS 28.04.2023

I. Me këtë Vendim **PEZULLOHET** përkohësisht zbatimi –implementimi i Rregullores për orarin e punës të veprimtarive ekonomike nr.15-330/02-22376 të datës 28.04.2023.

II. Pezullimi i zbatimit –implementimit të Rregullores për orarin e punës të veprimtarive ekonomike nr.15-330/02-22376 të datës 28.04.2023 sipas pikës I të këtij Vendimi bëhet për kohë të caktuar deri në plotësim dhe ndryshimin e Rregullores në fjalë.

III. Pezullim zbatimi i implementimit të kësaj Rregullore bëhet për arsye të ankesave të shumta të paraqitura me rastin e implementimit të saj.

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektorat.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15 Nr. 330/02-33618

Lipjan, më 30.06.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi